



VENDIM

Nr. 99, Datë 13.09.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË HEC – LANABREGAS
SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, në mbledhjen e tij të datës 13.09.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Ujesjelles Kanalizime” sh.a, për ndryshimin e liçensës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Hec Lanabregas sh.a, dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Ujesjelles Kanalizime” sh.a plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, germa “a”:**
Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)
- **Neni 15, pika 4, germa “b”:**
Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e liçensës me Nr. 145, Seria PV11SH, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr. 134, datë 6.12.2011 në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe liçensës me nr. 147, seria TPV11SH, miratuar me

Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 6.12.2011 në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Hec – Lanabregas sh.a.

2. Mbajtës i licencave të mësipërme do të jetë shoqëria “Ujësjellës Kanalizime sh.a”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim BOZGO**